# *Ç'është screening?*

**Screening është një program shtetëror për diagnostikimin e parakohshëm të sëmundjeve (tumoreve) për mbrojtjen e shëndetit tuaj:**

- është falas;
- është i thjeshtë;
- nuk është i dhimbshëm;
- mund t'a bësh afër shtëpisë;
- nuk kërkohet prenotim;
- nuk kërkohet impegnativa e mjekut;
- respekton privatësinë tuaj (Privacy) sipas ligjit në fuqi.




**Nëse nuk ju ka ardhur letra personale ose doni të informoheni më gjërësisht, mund të telefononi falas në numrin e Sekretarisë Screening të zonës suaj** (nga telefoni fiks ose nga celulari)

**AREA VASTA n.1**
**Fano** Numero Verde 800 710977
**Pesaro** Numero Verde 800 738073
**Urbino** Numero Verde 800 210858

**AREA VASTA n.3**
**Macerata**, **Civitanova Marche**,
**Camerino**
Numero Verde 800 178 008

**AREA VASTA n.5**
**San Benedetto**, **Ascoli Piceno**
Numero Verde 800 586 657

**AREA VASTA n.2**
**Ancona**, **Senigallia**,
**Jesi**, **Fabriano**
Numero Verde 800 267267

**AREA VASTA n.4**
**Fermo** Numero Verde 800 185 454

Shkarko APP gratis
për të gjitha informacionet.

Download on the App Store | ANDROID APP ON Google play

FSC
www.fsc.org
MISTO
Carta
da fonti gestite in
maniera responsabile
FSC® C102331

www.agenziaimage.it - 2019

il servizio sanitario *si prende cura di te*

# *Merrni pjesë në screening*
# *Mbroni shëndetin tuaj*

ALBANESE

Progetto finanziato da
INMP Istituto Nazionale per la promozione della salute delle popolazioni Migranti e per il contrasto delle malattie della Povertà
NIHMP National Institute for Health Migration and Poverty

REGIONE MARCHE · AGENZIA REGIONALE SANITARIA · SERVIZIO SANITARIO REGIONALE EMILIA-ROMAGNA Azienda Unità Sanitaria Locale di Reggio Emilia IRCCS Istituto in tecnologie avanzate e modelli assistenziali in oncologia · REGIONE CAMPANIA · Alisa Sistema Sanitario Regione Liguria · senza confini

## Screening i gjirit (MAMMOGRAFIA)



Është një ekzaminim **falas**, **i thjeshtë**, **i shpejtë** dhe **pa dhimbje**.

Screening bëhet nëpërmjet **mamografisë** (radiografi e gjirit) çdo **2 vjet** dhe shërben për **të verifikuar nëse gjiri juaj është normal**.

Nëse jeni **në moshën 50 deri në 69 vjeç** do t'ju ftojmë nëpërmjet **një letre personale**, ku do t'ju jetë **caktuar takimi** pranë shërbimit shëndetësor të zonës suaj.

Nëse është e nevojëshme, mund të ndryshoni datën ose orën e takimit duke telefonuar në numrin e shënuar në letrën personale.

Nëse nuk ju ka ardhur letra, telefononi Sekretarinë Screening të zonës suaj.

Përgjigjja në emrin tuaj do t'ju vijë në shtëpi me postë.

Nëqoftëse do të jetë e nevojëshme të bëni kontrolle të tjera do t'ju marrim në telefon.

## Screening i qafës së mitrës (PAP-TEST/HPV)

Është një ekzaminim **falas**, **i thjeshtë**, **i shpejtë** dhe **pa dhimbje**.

Screening bëhet për të **verifikuar normalitetin e qelizave të qafës së mitrës**.

Nëse jeni **në moshën** 25 deri në 34 vjeç do të bëni **PAP Test çdo 3 vjet**; nga mosha 35 deri në 64 vjeç do të bëni **HPV Test çdo 5 vjet**.

Nëse jeni **në moshën 25 deri në 64 vjeç**, do t'ju ftojmë nëpërmjet një **letre personale**, ku do t'ju jetë **caktuar takimi** pranë Konsultorit më afër shtëpisë suaj. Nëse është e nevojëshme, mund të ndryshoni datën ose orën e takimit duke telefonuar në numrin e shënuar në letrën personale.

Nëse nuk ju ka ardhur letra, telefononi Sekretarinë Screening të zonës suaj.

Përgjigjja në emrin tuaj do t'ju vijë në shtëpi me postë. Nëqoftëse do të jetë e nevojëshme të bëni kontrolle të tjera do t'ju marrim në telefon.



## Screening i zorrës së trashë

(SOF - KËRKIMI I GJAKUT OKULT NË FEÇE)



Është një ekzaminim **falas**, **i thjeshtë**, **i shpejtë** dhe **pa dhimbje**.

Screening bëhet për të **verifikuar nëse ka gjak që nuk shihet me sy në feçe (jashtëqitje)**; bëhet çdo **2 vjet**.

Nëse jeni **në moshën 50 deri në 69 vjeç** do t'ju ftojmë nëpërmjet një **letre personale**, me të gjithë **udhëzimet** për të tërhequr flakonin (epruvetën) për analizën e feçes dhe për t'a dorëzuar atë.

Nëse nuk ju ka ardhur letra, telefononi Sekretarinë Screening të zonës suaj.

Përgjigjja në emrin tuaj do t'ju vijë në shtëpi me postë.

Nëqoftëse do të jetë e nevojëshme të bëni kontrolle të tjera do t'ju marrim në telefon.